



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

URDHËR

Nr. 189, datë 27 . 06 .2020

**“PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KONSTITUIMIN, ORGANIZIMIN,
FUNKSIONIMIN DHE SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE
TË KOMISIONIT DISIPLINOR TË PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 73, pika 13, të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Rregullores për konstituimin, organizimin, funksionimin dhe shpërblimin e anëtarëve të Komisionit Disiplinor të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet anëtari i zgjedhur nga Ministri i Drejtësisë që brenda 10 ditëve nga zgjedhja e anëtarëve të komisionit, të thërrasë mbledhjen e parë të komisionit.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë dhe Komisioni Disiplinor, për zbatimin e këtij urdhri.
4. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren Zyrtare”.

MINISTRI

ETILDA GJONAJ (SALIU)



**RREGULLORE PËR KONSTITUIMIN, ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN
DHE SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT DISIPLINOR
TË PËRMBARUESVE GJYQËSORE PRIVATË**

**TITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Kjo rregullore përcakton rregulla të hollësishme për konstituimin, organizimin, funksionimin dhe shpërblimin e anëtarëve të Komisionit Disiplinor, bazuar në kërkesat e ligjit për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat dhe parimet e përgjithshme të Kodit të Procedurave Administrative.

**Neni 2
Përkufizime**

Në kuptim të kësaj rregulloreje, me termat e mëposhtëm do të kuptohet:

- a) “Komision Disiplinor” do të thotë komision hetimor “*ad hoc*”, i cili mbështetet administrativisht nga Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë dhe shqyrton kërkesat e Ministrit të Drejtësisë për procedim disiplinor ndaj përmbaruesve gjyqësorë privatë;
- b) “Hetime” janë tërësia e veprimeve procedurale administrative që ndërmerren nga Komisioni Disiplinor për të sqaruar një çështje të veçantë;
- c) “Provë” është çdo e dhënë, dëshmi, dokument apo fakt që shërben në nxjerrjen e konkluzioneve të hetimit dhe që merret sipas dispozitave ligjore dhe kësaj rregulloreje.
- ç) “Dëshmitar” është personi i thirrur nga Komisioni Disiplinor për të dëshmuar mbi ngjarjet dhe faktet vetëm dhe për shkak të lidhjes me çështjen objekt shqyrtimi;
- d) “Ekspertë” janë persona që për shkak të njohurive të posaçme në fushat e shkencës, teknikës, apo në fusha të tjera specifike thirren nga Komisioni Disiplinor, kur kjo e fundit e konsideron të përshtatshme;
- dh) “Vendim jo përfundimtar” është vendimi i Komisionit Disiplinor, i marrë në çdo fazë të procedimit disiplinor për zhvillimin normal të veprimtarisë dhe procedurave të mëtejshme të hetimit, të pyetjes së dëshmitarëve, shtyrjes së seancës, angazhimin e ekspertëve dhe përcaktimin e detyrave të tyre, pranueshmërinë e provave, si dhe për çdo çështje tjetër që Komisioni Disiplinor e vlerëson të nevojshme ose të përshtatshme në trajtimin e çështjes;
- e) “Vendim përfundimtar” është vendimi merret nga Komisioni Disiplinor, për pranimin e kërkesës për procedim disiplinor dhe marrjen e një ose më shumë masave disiplinore ose rrëzimin e kërkesës.

Neni 3

Fusha e veprimtarisë së Komisionit

Komisioni Disiplinor është krijuar me ligj për të hetuar, shqyrtuar dhe vendosur mbi të gjitha rastet që lidhen me procedimet disiplinore ndaj përmbaruesve gjyqësorë privatë, pas paraqitjes së raportit të hetimit së bashku me dosjen hetimore përkatëse nga Ministri i Drejtësisë.

TITULLI II

KONSTITUIMI I KOMISIONIT DISIPLINOR

Neni 4

Krijimi i Komisionit

1. Komisioni Disiplinor është një organ *ad hoc* i krijuar nga ligji për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat.
2. Përbërja e tij është e parashikuar me ligj.

TITULLI III

ORGANIZIMI, FUNKSIONIMI DHE SHPËRBLIMI I KOMISIONIT DISIPLINOR

Neni 6

Mënyra e organizimit të Komisionit Disiplinor dhe shpërblimi

1. Mbledhja e Komisionit Disiplinor është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.
2. Kryetari i Komisionit Disiplinor zgjidhet njëri nga anëtarët e Komisionit Disiplinor.
3. Në mbledhjen e parë të Komisionit Disiplinor zgjidhet kryetari me shumicën e të gjithë anëtarëve të Komisionit. Mandati i kryetarit është 2-vjeçar.
4. Komisioni Disiplinor mblidhet jo më vonë se 15 ditë nga mbarimi i mandatit të kryetarit për të zgjedhur kryetarin e ri.
5. Veprimtaria administrative e Komisionit Disiplinor mbështetet nga stafi administrativ i Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë.
6. Masa e kompensimit është 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për Kryetarin e Komisionit Disiplinor dhe 10 000 (dhjetë mijë) lekë për secilin anëtar të Komisionit Disiplinor për çdo kërkesë që shqyrtohet nga momenti i depozitimit, deri në vendimmarrjen përfundimtare të Komisionit.
7. Shpenzimet për pagesën e anëtarëve për çdo kërkesë të marrë në shqyrtim përballohen nga Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë për anëtarin e zgjedhur prej saj dhe nga

Ministria e Drejtësisë për anëtarin e zgjedhur nga Ministri i Drejtësisë dhe nga Shkolla e Magjistraturës.

8. Shpenzimet për mbulimin e kostove administrative të punës së Komisionit Disiplinor përballohen nga Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë.

Neni 7

Heqja dorë ose përjashtimi i anëtarit

1. Anëtarët e Komisionit Disiplinor duhet të tërhiqen nga shqyrtimi i një procedimi disiplinor në rastet kur ekzistojnë një nga pengesat ligjore të parashikuara në nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative. Në këtë rast, anëtari njofton Kryetarin për heqjen dorë nga shqyrtimi i procedimit disiplinor jo më vonë se 3 ditë nga data e marrjes dijeni të pengesës ligjore. Në rastet kur heq dorë Kryetari, njoftohet anëtari i zgjedhur nga Ministri i Drejtësisë ose anëtari i zgjedhur nga Shkolla e Magjistraturës, kur anëtari i zgjedhur nga Ministri i Drejtësisë është zgjedhur njëkohësisht edhe Kryetar.

2. Ministri i Drejtësisë ose përmbauesi ndaj të cilit po ushtrohet procedimi, mund të kërkojë përjashtimin e një anëtari nga procedimi disiplinor, deri në kohën e marrjes së vendimit, duke parashtruar arsyet për të cilat kërkohet përjashtimi nga shqyrtimi i procedimit disiplinor. Kërkesa bëhet me shkrim, i drejtohet Kryetarit dhe përmban të gjitha provat e mundshme në të cilat ajo mbështetet. Në rastet kur kërkesa për përjashtim paraqitet ndaj Kryetarit, kërkesa i drejtohet anëtarit të zgjedhur nga Ministri i Drejtësisë ose anëtarit të zgjedhur nga Shkolla e Magjistraturës, kur anëtari i zgjedhur nga Ministri i Drejtësisë është zgjedhur njëkohësisht edhe Kryetar.

3. Në çdo rast, deri në shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin e anëtarit pezullohet shqyrtimi i procedimit disiplinor.

4. Komisioni Disiplinor merr vendim për përjashtimin ose konfirmimin e anëtarit, brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës së palëve. Anëtari i Komisionit Disiplinor ndaj të cilit është paraqitur kërkesa nuk merr pjesë në shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin e tij.

5. Kur Komisioni Disiplinor vendos përjashtimin e anëtarit, në vendimin e përjashtimit caktohet edhe anëtari zëvendësues për shqyrtimin e procedimit disiplinor. Anëtar zëvendësues caktohet kandidati, që në përfundim të procedurës së përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit Disiplinor, është renditur menjëherë pas anëtarëve fitues në listë. Në rast se ky kandidat nuk pranon për t'u caktuar si anëtar zëvendësues, caktohet kandidati i renditur menjëherë pas tij.

6. Në rastet e përjashtimit dhe pamundësisë së zëvendësimit, organi funksionon si i tillë pa pjesëmarrjen e anëtarit të përjashtuar.

Neni 8

Kompetencat funksionale të Komisionit Disiplinor

1. Komisioni Disiplinor shqyrton të gjitha raportet e hetimit së bashku me dosjet hetimore të Ministrisë së Drejtësisë për procedimin disiplinor ndaj përmbauesve gjyqësorë privatë.

2. Komisioni Disiplinor kryen të gjitha veprimet e nevojshme hetimore me qëllim realizimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm administrativ në përputhje me normat Kodit të Procedurave Administrative, kur ligji për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat nuk parashikon ndryshe.

Neni 9

Detyrat e kryetarit dhe anëtarit të Komisionit

1. Kryetari i Komisionit kryen këto detyra:

- a) administron raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore të paraqitur nga Ministri i Drejtësisë për procedimin disiplinor ndaj përmbartuesit;
- b) informon anëtarët e tjerë të Komisionit dhe përmbartuesin subjekt të procedimit, me kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë për procedimin disiplinor;
- c) cakton dhe njofton kohën dhe vendin e seancës dhe merr konfirmimin me shkresë ose mjete elektronike të anëtarëve të Komisionit Disiplinor, palëve si dhe personave të tjerë të interesuar të cilët do të jenë pjesëmarrës në seancë. Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm anëtarët e nevojshëm për kuorumin e mbledhjes, Kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër të afërt. Në rast se subjekti i procedimit disiplinor ose përfaqësuesi ligjor i tij nuk është i pranishëm, vlerëson shkaqet e mosparaqitjes në seancë. Në rast se mosparaqitja ka ndodhur për shkaqe që nuk vlerësohen të arsyeshme, vendos vijimin e seancës pa praninë e subjektit ose përfaqësuesit të tij ligjor. Në rastet kur vlerësohet se subjekti i procedimit ka paraqitur shkaqe të arsyeshme apo shkaqe të cilat vlerësohen si të tilla, Komisioni shtyn mbledhjen duke kryer një njoftim të dytë për një datë tjetër sa më të afërt. Nëse edhe në këtë datë subjekti i njoftuar rregullisht dhe/ose përfaqësuesi i tij nuk paraqiten para Komisionit, vendoset vazhdimi i seancës në mungesë.
- ç) cakton dhe njofton rendin e ditës së mbledhjes si dhe cakton relatorin e çështjes, referuar dosjes hetimore përkatëse për procedim disiplinor të paraqitur nga Ministri i Drejtësisë;
- d) informon anëtarët e Komisionit në lidhje me detyrimin për t'u shprehur brenda 2 (dy) ditësh nga momenti i marrjes së njoftimit, nëse kanë konflikt interesi apo dyshime mbi paanësinë e tyre në vendimmarrje, si dhe përmbartuesin gjyqësor, subjekt të procedimit disiplinor nëse ka konflikt interesi me një prej anëtarëve të Komisionit Disiplinor;
- dh) merr vendim për tërheqjen e anëtarit të Komisionit Disiplinor, kur ka konflikt interesi apo ka dyshime në lidhje me paanësinë e tyre në vendimmarrje, jo më vonë se 5 (pesë) ditë përpara datës së seancës;
- e) hap, mbyll dhe drejton mbledhjen duke siguruar mbarëvajtjen e saj në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje;
- ë) pyet nëse ka kërkesa paraprake nga palët. Kërkesat paraprake vlerësohen nga Komisioni Disiplinor me vendim jo përfundimtar.
- f) shtyn apo mbyll para kohe mbledhjet, në mënyrë të përligjur, duke e arsyetuar me vendim të pasqyruar në procesverbalin përkatës;
- g) nënshkruan të gjithë aktet e nxjerra nga Komisioni;
- gj) administron materialet e nevojshme, të cilat kërkohen nga anëtarët e tjerë;
- h) kryen ballafaqimet dhe saktësimet e kërkuara nga anëtarët e tjerë si dhe njofton mbylljen e diskutimeve;

- i) thërret dëshmitarë nëse ka, për dëshmi shtesë apo ekspertët nëse janë të angazhuar nga Komisioni;
 - j) u jep fjalën anëtarëve të tjerë të Komisionit ose personave të tjerë të interesuar, nëse ata e kërkojnë, për të paraqitur pretendimet dhe sqarimet e tyre;
 - k) siguron zbatimin e ligjit procedural dhe material të zbatueshëm për organet kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike dhe marrjen e vendimeve të drejta.
2. Në rastet kur Kryetari, nuk thërret mbledhjen brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të nenit 10 ose nuk merr pjesë në të, pavarësisht shkakut, detyrat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, ushtrohen nga anëtari i zgjedhur nga Ministri i Drejtësisë ose anëtari i zgjedhur nga Shkolla e Magjistraturës, kur anëtari i zgjedhur nga Ministri i Drejtësisë është zgjedhur njëkohësisht edhe Kryetar.
3. Anëtari i Komisionit kryen të paktën këto detyra:
- a) përcjell me shkrim ose në rrugë elektronike konfirmimin për pjesëmarrje në mbledhje pranë Kryetarit të Komisionit Disiplinor;
 - b) bën relatimin e çështjes në seancë para Komisionit Disiplinor, në rastin kur ai është anëtari i zgjedhur nga Kryetari sipas germës “ç” të pikës 1 të këtij neni;
 - c) ruan të dhënat me të cilat është njohur gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij duke respektuar parimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi;
 - ç) tërhiqet nga shqyrtimi i çështjes, nëse ndodhet para kushteve të përcaktuara në shkronjën “d”, të pikës 1 të këtij neni.
 - d) voton për vendimet që merr Komisioni Disiplinor, me përjashtim të rastit kur tërhiqet nga shqyrtimi i çështjes, sipas germës “ç”, të pikës 2 të këtij neni.

Neni 10

Mbledhja e Komisionit

1. Komisioni mblidhet dhe zhvillon seancën dëgjimore jo më vonë se 15 ditë nga paraqitja e raportit të hetimit së bashku me dosjen hetimore nga Ministri i Drejtësisë për procedim disiplinor.
2. Kryetari cakton datën e mbledhjes jo më vonë se 3 ditë nga marrja e raportit të hetimit. Çdo ndryshim për datën e mbledhjes i njoftohet pa vonesë çdo anëtari të Komisionit. Afati për zhvillimin e seancës dëgjimore mund të zgjatet deri në 45 ditë, nëse Komisionit Disiplinor është i bindur se ka arsye të rëndësishme për shtyrjen.
3. Dokumentimi i të gjithë veprimtarisë së Komisionit gjatë mbledhjes pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes , i cili mbahet nga sekretari që zgjidhet nga rradhët e anëtarëve, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Kryetarit dhe përmban:
 - a) datën dhe vendin e mbledhjes;
 - b) anëtarët që marrin pjesë në mbledhje;
 - c) çështjet që u diskutuan në mbledhje;
 - ç) vendimet që u morën në mbledhje, argumentet për vendimmarrje, afatet e përcaktuara në vendimmarrje;
 - d) dorëheqjet e anëtarëve dhe arsyetimet përkatëse;
 - dh) formën e votimit (i hapur ose jo) dhe rezultatin e tij;
 - e) rezultatet e votimit, mënyrën e votimit të secilit anëtar dhe arsyetimin e votimit nga secili anëtar;

4. Procesverbali i mbledhjes u paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit, procesverbali nënshkruhet së bashku nga Kryetari, sekretari dhe nga anëtari i zgjedhur nga Ministri i Drejtësisë, kur ky i fundit nuk është caktuar si sekretar.

5. Mbledhjet e Komisionit Disiplinor dokumentohen edhe nëpërmjet regjistrimit audio.

6. Një kopje e procesverbalit të mbledhjes, regjistrimi audio, transkriptimi i tij, nëse është e mundur dhe të çdo materiali tjetër të administruar gjatë zhvillimit të saj depozitohet së bashku me vendimin përfundimtar të arsyetuar pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 11

Detyrimi për të marrë pjesë në mbledhje

1. Pjesëmarrja në mbledhjet e Komisionit Disiplinor është e detyrueshme. Në rastet kur një anëtar nuk merr pjesë në tre mbledhje të njëpasnjëshme, pa një shkak të ligjshëm, konsiderohet që ka hequr dorë si anëtar i Komisionit Disiplinor. Në këtë rast kryetari, ose në rastin kur kryetari nuk merr pjesë në tre mbledhje të njëpasnjëshme, anëtari i zgjedhur nga Ministri i Drejtësisë njofton menjëherë organin e emërtesës dhe Ministrinë e Drejtësisë.

2. Organi i emërtesës fillon procedurën për zgjedhjen e anëtarit të ri të Komisionit Disiplinor jo më vonë se 15 ditë nga data e marrjes së njoftimit.

Neni 12

Marrja e vendimeve nga Komisioni

1. Mbledhja e Komisionit është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.

2. Komisioni Disiplinor merr vendim në lidhje me angazhimin e ekspertëve dhe përcaktimin e detyrave të tyre, shtyrjen e seancave, pranueshmërinë e provave, zgjidhjen e çështjes si dhe çdo çështje tjetër që e vlerëson të nevojshme ose të përshtatshme në trajtimin e çështjes.

3. Komisioni merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes.

4. Marrja e vendimeve në mbledhjen e komisionit bëhet me votim, i cili është individual dhe i hapur.

5. Përrjashtimisht, votimet që kanë të bëjnë me etikën, cilësitë ose sjelljet e subjektit të procedimit disiplinor merren me votim të fshehtë.

6. Secili prej anëtarëve ka të drejtën e ushtrimit të një vote. Në asnjë rast, e drejta e votës nuk mund t'i delegohet ndonjë anëtar tjetër të Komisionit.

7. Përrjashtimisht, votimet që kanë të bëjnë me etikën, cilësitë ose sjelljet e përmbartuesit gjyqësor merren me votim të fshehtë.

8. Vendimet e Komisionit Disiplinor miratohen me shumicën e të gjithë anëtarëve të Komisionit.

9. Anëtari në pakicë mund të kërkojë që të shënohet në procesverbal fakti dhe arsyet e votimit kundër një vendimi të marrë nga Komisioni.

10. Votat e anëtarëve të Komisionit Disiplinor regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes

TITULLI IV PROCEDURA PËRPARA KOMISIONIT DISIPLINOR

Neni 13

Nisja e procedurës

1. Ministri i Drejtësisë, me kërkesë të tij dhe duke u bazuar në rezultatet e hetimit, ndërmerr nismën e fillimit të procedimit disiplinor duke ia kaluar raportin e hetimit dhe dosjen hetimore Komisionit Disiplinor.
2. Procedimi disiplinor kundër përmbauesit gjyqësor privat fillon kur gjatë hetimit që ka zhvilluar Ministria e Drejtësisë konstatohen shkelje të detyrës apo veprime të parregullta gjatë ushtrimit të veprimtarisë së përmbauesit gjyqësor privat.
3. Procedimi disiplinor kundër përmbauesit gjyqësor privat vazhdon edhe në rast se pala në proces ekzekutimi tërheq ankimin dhe gjatë verifikimit janë konstatuar shkelje të detyrës apo veprimeve të parregullta të kryera gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Neni 14

Njoftimi i subjektit ndaj të cilit ka filluar procedimi disiplinor

1. Subjekti i procedimit njoftohet të paktën 10 ditë përpara zhvillimit të seancës në lidhje me datën, orën dhe vendin e zhvillimit.
2. Subjekti i procedimit njoftohet në lidhje me:
 - a) për të paraqitur një parashtrësë me shkrim në afatin e caktuar;
 - b) për të marrë pjesë në seancë dëgjimore;
 - c) për të thirrur dëshmitarë që mund të dëshmojnë fakte me interes për çështjen;
 - ç) për të paraqitur dokumente;
 - d) për të marrë masa të tjera për paraqitjen e provave në mbështetje të mbrojtjes së tij;
 - dh) për t'u përfaqësuar, sipas parashikimeve të Kodin të Procedurave Administrative
3. Njoftimi i subjektit, për të cilin është vendosur fillimi i procedimit disiplinor bëhet nëpërmjet postës elektronike zyrtare të përmbauesit gjyqësor apo në rrugë postare në adresat e deklaruara në "Regjistrin e përmbauesve gjyqësorë privatë" dhe "Regjistrin unik të të dhënave për zyrat përmbaimore dhe përmbauesit gjyqësorë privatë".
4. Palët kanë të drejtë të njoftohen për çdo vendim të Komisionit Disiplinor brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

Neni 15

Përfundimi i procedimit disiplinor

1. Pas shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe provave, Komisioni Disiplinor vendos:
 - a) rrezimin e kërkesës për procedim disiplinor, për shkak se faktet e pretenduara nuk kanë ndodhur ose ato nuk përbëjnë shkelje disiplinore; ose

b) pranimin e kërkesës, marrjen e një ose më shumë masave disiplinore dhe njoftimin e vendimit ministrit.

2. Komisioni Disiplinor shqyrton masën disiplinore të propozuar nga ministri dhe jep vendim të arsyetuar me shkrim brenda dy javëve nga përfundimi i seancës.

3. Vendimi përfundimtar përmban:

- a) organin që ka marrë vendimin;
- b) identitetin e subjektit ndaj të cilit është zhvilluar procedimi disiplinor;
- c) datën e miratimit;
- ç) rrethanat e faktit dhe shkelja/shkeljet e pretenduara;
- d) bazën ligjore;
- dh) pjesën arsyetuese;
- e) dispozitivin që tregon;
- ë) të drejtën dhe afatet e ankimit;
- f) nënshkrimin e Kryetarit dhe sekretarit të Komisionit Disiplinor.

Neni 16

Nxjerrja e urdhrit të ministrit të Drejtësisë

1. Ministri i Drejtësisë, brenda 2 javëve nga data e paraqitjes së vendimit të Komisionit Disiplinor dhe materialeve shoqëruese ose brenda 1 muaji në rastin e gjobës, nxjerr urdhrin për zbatimin e masave që vendosen në procedimin disiplinor, në të cilin parashikohen edhe modalitetet e zbatimit të tij.

2. Urdhri për zbatimin e masës disiplinore jepet i arsyetuar dhe i njoftohet subjektit të procedimit dhe dhe Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, me shkrim brenda 5 ditëve nga nxjerrja e tij.

3. Vendimi i Komisionit Disiplinor, pas kalimit të afatit të ankimit, ose kur lihet në fuqi nga gjykata, evidentohet në regjistrat e përmbauesve gjyqësorë privatë të parashikuar në nenin 23 të ligjit për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat.

Neni 17

Ankimi

Kundër vendimeve të Komisionit Disiplinor mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.